



# UNIVERSITETI SHTETËROR I TETOVËS

STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

SUT Rectorate - Ilinden nn, 1200 Tetovo, Macedonia  
Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: [international@unite.edu.mk](mailto:international@unite.edu.mk)

Në bazë të nenit 131 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së, nr. 35/08, nr.103/2008, nr. 26/2009, nr.83/2009, nr.99/2009, nr.115/2010) dhe nenit 144 të Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës, Këshilli i Rektoratit të USHT-së në mbledhjen e mbajtur më datë 18.01.2011 shpall:

## KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimeve në thirrje mësimore-shkencore në Univeristetin Shtetëror të Tetovës

A. Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimeve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

### FAKULTETI JURIDIK

1. Një mësime për lëndët:
  - E drejta kushtetuese,
  - E drejta administrative

### FAKULTETI EKONOMIK

1. Një mësime për lëndët:
  - Menaxhimi investues,
  - Menaxhimi financiar,
  - Menaxhimi i resurseve njerëzore,
  - Financat ndërkombëtare

### FAKULTETI FILOLOGJIK

1. Një mësime lëndët e letërsisë
2. Një mësime lëndët:
  - Fonologji,
  - Leksikologjia anglishte
3. Një mësime për lëndët:
  - Letërsi e Maqedonisë mesjetare,
  - Letërsi popullore,
  - Letërsia maqedone e shekullit XIX
4. Një mësime për lëndën Gjuhë angleze (në programe tjera studimore)

## **FAKULTETI FILOZOFIK**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Historia e integrimeve evropiane,
  - Historia e Maqedonisë antike,
  - Historia e Maqedonisë mesjetare,
  - Historia e religjioneve
2. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Metodat e anketimit,
  - Metodika e mësimdhënies së sociologjisë I dhe II,
  - Globalizimi dhe civilizimi
3. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Ekologjia sociale,
  - Sociologjia e grupeve etnike,
  - Sociologjia e punës, sistemi politik në RM
4. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Psikometri I,
  - Psikometri II,
  - Metodologjia e psikologjisë joeksperimentale,
  - Metodologjia e psikologjisë eksperimentale

## **FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE**

1. Një mësimdhënës për lëndët në lëminë e kulturës fizike

## **FAKULTETI I ARTEVE**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Grafikë A1, A2, A3 A4 ,
  - Teknikat e grafikës 1, 2, 3

## **FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO NATYRORE**

1. Një mësimdhënës për lëndët në lëminë e gjeografisë
2. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Matematika për ekonomist,
  - Algjebër II

## **FAKULTETI I SHKENCAVE TË MJEKËSISË**

1. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Anatomia normale e njeriut,
  - Histologji
2. Një mësimdhënës për lëndët:
  - Fiziologji,
  - Patofiziologji

**B.** Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore të parapara me Ligjin për arsimin e lartë.

**C.** Kandidatët bashkë me fletëparaqitjen duhet t'i dorëzojnë në origjinal, ose kopje të vërtetuara në noter, këto dokumente:

**Në thirrjen docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent- Këshillit mësimor-shkencor të institucionit të arsimit të lartë, nëse e posedon;
- Diplomë të nostrifikuar për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore, magjistër i shkencave, ose gradën shkencore-doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtë (CV);
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë për nënshtetësi.
- Mësimdhënësit që do të zgjedhen do të nënshkruajnë marrëveshje me Rektorin, sipas të cilës do të obligohen që për pesë (5) vitet e ardhshme të mos e ndërpresin marrëdhënien e punës në USHT.

**D.** Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 8 ditësh, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Tetovë,28.01.2011 Universiteti Shtetëror i Tetovës**